

Nr. .... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2022

## SPECIFIKIME TEKNIKE

### 1.OBJEKTI I PROKURIMIT:

Pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e agregatëve e pajisjeve të centralit HEC Fierzë.

### 2. QËLLIMI I BLERJES

Pjesët rezervë nevojiten të sigurohen për mirëmbajtjen periodike të sistemeve dhe pajisjeve të ndryshme për HEC Fierzë si dhe për kthimin në gadishmëri për funksionim normal brenda parametrave optimalë të këtyre pajisjeve. Sigurimi i pjesëve rezervë të nevojshme minimizon mundësinë për dëmtim të pajisjeve dhe nyjeve kryesore të agregatëve.

### 3. TË PËRGJITHSHME

Shërbimet e mirëmbajtjes për të cilat nevojiten këto pjesë rezervë, të cilat kërkohen të prokurohet, shërbejnë për të ruajtur cilësinë dhe sigurinë e pajisjeve dhe agregatëve. Pjesët rezervë të kërkuara ndodhen në nyje të rëndësishme të pajisjeve të agregatëve.

### 4. PJESËT REZERVË ELEKTRIKE

Nr.	Emërtimi i pjesës	Karakteristikat teknike	Njësia	Sasia	Shënime
1.	Automat tre fazor	Referuar automatit ekzistues ABB, ose ekuivalent Tipi: SACE S2S MCCB $I_{th}=70-100A$ $U_e=380V$ Automat i tarueshëm	copë	8	Panelet e nevojave vetjake të Agregateve. Bashkëlidhur foto.
2.	Automat tre fazor (I motorizuar)	Referuar automatit ekzistues ABB, ose ekuivalent Tipi: SACE S6N karrocë (withdrawable) Njësi mbrojtje elektronike me funksione mbrojtje L, S, I, G sipas IEC $I_n=630A$ $U_e=690V$	copë	4	Panelet e nevojave vetjake të Agregateve. Bashkëlidhur foto.
3.	Automat tre fazor	Referuar automatit ekzistues ABB, ose ekuivalent Tipi: SACE S6N MCCB $I_n=630A$ $U_e=690V$	copë	4	Panelet e nevojave vetjake të Agregateve. Bashkëlidhur foto.

		Njësi mbrojtje elektronike me funksione mbrojtje L, S, I, G sipas IEC.			
4.	Automat tre fazor	Referuar automatit ekzistues ABB, ose ekuivalent Tipi: SACE S3N $I_n=200A$ $U_e=690V$ Automat i pajisur me levë komanduese manuale dhe aksesori për montimin e levës në derën e panelit	copë	6	Panelet e nevojave vetjake të Centralit. Bashkëlidhur foto.
5.	Automat tre fazor	Referuar automatit ekzistues ABB, ose ekuivalent Tipi: SACE S5N $I_n=320A$ $U_e=690V$ Njesi trippi elektronike me funksion mbrotje I. I tarueshëm nga $1.5-12 \cdot I_n$ Automat i pajisur me levë komanduese manuale dhe aksesori për montimin e levës në derën e panelit.	copë	4	Panelet e nevojave vetjake të Centralit. Bashkëlidhur foto.
6.	Çelës industrial rrjeti (RS2 HUB FOR S8000-E optic fiber network)	Referuar çelësit ekzistues HIRSCHMANN, ose ekuivalent Tipi: RS2-FX/FX; multimode ports (RJ45 connector) $U_{in}=24VDC$ , $I_{in}=0.4A$	copë	4	Panelet e sistemit të kontroll-monitorimit. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
7.	Blllok ushqimi AL02S	Referuar ekzistuesit Axilec, ose ekuivalent Tipi: AL02S Input: 220VAC, 48VDC Output: 220VAC, 24VDC, 48VDC	copë	2	Panelet e sistemit të kontroll-monitorimit. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
8.	Butona komandimi	Tipi: SK616001-A, ose ekuivalent $U=380V\sim$ $I=4-8A$	copë	20	Panelet e ushqimit të paisjeve ndihmëse në Central. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi dhe foto.
9.	Kontaktor	Referuar ekzistuesit ABB, ose ekuivalent Tipi: EH210 $U=380-415V$ ; $I=300A$ ; $P=110KW$ ;	copë	6	Panelet e ushqimit të pompave të Thellësisë. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi dhe foto.

10.	Llampa sinjalizimi	24 VDC/48VDC/ 230VAC	copë	50	Panelet e ushqimit të pajisjeve ndihmëse në Central. Bashkëlidhur foto.
11.	Kontaktor rele me 8 kontakte ndihmëse 6NO dhe 2NC	Referuar ekzistuesit SIEMENS, ose ekuivalent Tipi: 3TH42 62E 380VAC, 16-25A; Bobina 220 VDC	copë	10	Paneli VOITH Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
12.	Kontaktor rele me 8 kontakte ndihmëse 4NO dhe 4NC	Referuar ekzistuesit SIEMENS, ose ekuivalent Tipi: 3TH42 62E 380VAC, 16-25A; Bobina 220 VDC	copë	10	Paneli VOITH Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
13.	Monitor për panelet PLC	Referuar ekzistuesit CTC Parker, ose ekuivalent Tipi: PA10T-133 10 inch tft LCD monitor me prekje  Rezolucioni VGA 640 x 480 pixel 12VDC/1A 24VDC/0.5A 12W CompactFlash External	copë	4	Panelet e sistemit të kontroll-monitorimit. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi dhe foto.
14.	Monitor për panelet DTL	Tipi: PCS 950q , ose ekuivalent 24VDC ± 20%; 25VA	copë	4	Panelet e DTL-ve të Agregatëve. Bashkëlidhur foto.
15.	Morseteri linjash	U=220kV për përcjellës AlÇ 400mm <sup>2</sup>	copë	20	Nënstacioni 220kV/110kV/10kV Bashkëlidhur foto.
16.	Karbonçina	Tipi: E01B, ose ekuivalent (25x32x50) mm	copë	500	Në sistemin e eksitimit të Agregatëve
17.	Ventilator për panelet e kontroll monitorimit	Referuar ekzistuesit ebm U= 230VAC 50/60Hz, 45/39 W me mbrojtje termike. TipTubeaxial: Diameter 150mm, Thellësi 55mm Fluksi i ajrit 6.3 m <sup>3</sup> /min Model W2S130-AA03-77, ose ekuivalent	copë	10	Montuar tek panelet e kontroll monitorimit të agregatit. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
18.	Shufër rrethore Teflon PTFE (Lingote)	Gjatësia L = 1000 mm, Diametri i jashtëm Dj = 100mm	copë	2	Për aplikime të ndryshme

## 5. PJESËT REZERVË MEKANIKE

Nr.	Emertimi i pajisjes	Karakteristikat teknike	Nësia	Sasia	Përdorimi
1.	Valvol e reduktimit të presionit	Tipi DVP, ose ekuivalente PN= 16 bar. P2 = 3.5 bar, DN 200	copë	2	Shërben për uljen e presionit të ujit Teknik. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
2.	Valvola kryesore e ujit teknik	Referuar ekzistueses F&M, ose ekuivalente Tipi Hydr. FL-Valve DN200 PN16	copë	2	Komandohet me vaj me presion për hapje/mbyllje të ujit teknik. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
3.	Shkarkues automatik i kondensatit	Referuar ekzistueses BEKOMAT, ose ekuivalente 12 Co PN 63 20000 18-10232466 G ½", 230 VAC/50 Hz	copë	3	Shkarkon ne menyre automatike kondensatin e depozituar ne dep.e ajrit. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
4.	Filtër ajri	Referuar ekzistueses Domnick Hunter, ose ekuivalente Tipi Lod.No.AO 0030G, ose ekuivalente G ½" /108m³/min 1 ym	copë	2	Filtër ajri i komardares. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
5.	Elektrovalvol e rrugës së vajit për komandimin e ujit teknik	Referuar ekzistueses BOSCH, ose ekuivalente Tipi:081WV10P1V1020WS220 /00 DN10, 220VDC, 35W	komplet	4	Komandon me vaj me presion për hapje/mbyllje të ujit teknik. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
6.	Elektrovalvol e servomotorit, RASH dhe emergjencës	Referuar ekzistueses BOSCH, ose ekuivalente Tipi:081WV10P1V1020WS230 /00 DO/2XINI 048 DN10, 220VDC, 35W	komplet	4	Komandimi i servomotorit, komanda start-stop, emergjenca. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.

7.	Valvol hidraulike për kthimin e emergjencës	Referuar ekzistueses BOSCH, ose ekuivalente Tipi:081WV10P1V2012-DO DN10	komplet	2	Shërben për kthimin e valvolës së emergjencës. Bashkëlidhur foto.
8.	Konektor	Referuar ekzistueses Murr Elektronik, ose ekuivalente Tipi:3129025 230V AC/DC, 0.5A	copë	10	Shërben për lidhjen elektrike të bobinave të elektrovalvolave. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
9.	Saraçineskë 500mm	Referuar ekzistueses F&M Armaturen, ose ekuivalente Tipi:GS-C25N/X20Cr14 DN 500, PN 16	copë	1	Shërben për boshatisjen e dhomës spirale. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
10.	Pompë pikimi vaji (elektromotor +pompë)	Referuar ekzistueses Boldrocchi, ose ekuivalente Motorri elektrik tip: SH 90L-6; Pompa e vajit tip 2CY- 2/14.5-1 Elektromotori: 1.1KW, 920 rrot/min, 220-380V (AC), 5.3-3.1A. Pompa: 0.55 l/sek (dalja e vajit nga pompa 3/4")	komplet	2	Shërben për kthimin në sistem të pikimeve të vajit në galerinë e Turbinës. Bashkëlidhur foto.
11.	Elektrovalvol për portat e Veprës së Marrjes	Referuar ekzistueses Tiefenbach, ose ekuivalente Per elektrovalvol tip: 03-05025500 DN6, PN320, 220VDC, 1341Ω, 36W	komplet	2	Shërben për komandimin e portave në Veprën e Marrjes. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
12.	Sensor i pozicionit të valvolës kryesore	Referuar ekzistueses Temposonics, ose ekuivalente Tipi RH-M-0070M-D70-1-S2G11 24 VDC,70mm, gri, 24 Bit	copë	4	Tregon pozicionin e valvolës kryesore në rregullator. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
13.	Sensor i pozicionit të aparatit drejtues	Referuar ekzistueses Temposonics, ose ekuivalente Tipi RH-M-0450M-D70-1-S2G11 24 VDC, L=450mm, gri, 24 Bit	copë	4	Tregon pozicionin e aparatit drejtues. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.

14.	Ajërtharësi KPL	Referuar ekzistueses Domnick Hunter (Hiross), ose ekuivalente Tipi PHP030 230V, 50Hz, 1.4KW, 7.3A, Presioni: 0.1-1.2MPa; Temp. ajrit: 5-50 <sup>0</sup> C	copë	1	Shërben për tharjen e ajrit në linjën e Kompresorëve të Presionit të Lartë. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
15.	Ajërtharësi KPU	Referuar ekzistueses Domnick Hunter, ose ekuivalente Tipi CRD0380 230V, 50Hz, 0.9KW, 4.2A, Presioni: 0.3-5MPa; Temp. ajrit: 5-50 <sup>0</sup> C	copë	1	Shërben për tharjen e ajrit në linjën e Kompresorëve të Presionit të Ulët. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
16.	Manometër	Referuar ekzistueses Wika, DSD, ose ekuivalente Tipi 111 A = unten D160 / 0-16 bar	copë	50	Shërbejnë për matjen e presionit të ujit Teknik. Bashkëlidhur, skeda e të dhënave teknike nga prodhuesi.
17.	Pompa zhytëse kapaku i turbinës	Qmin. =20 l/min, Hmin =2m, Pmin.=0.75W, U=220-240VAC, F=50Hz, me galixhant	copë	4	Shërben për largimin e ujit nga kapaku i turbinës

## **6. KËRKESAT TEKNIKE TË PJSËVE REZERVË ELEKTRIKE DHE MEKANIKE**

1. Të gjitha produktet duhet të jenë konform standarteve kombëtare apo ndërkombëtare në fuqi për atë lloj pajisje.
2. Në të gjithë pjesët ku përdoret marka ose tipi për referim, nuk përjashtohen produktet ekuivalente që plotësojnë specifikimet teknike.
3. Afati kohor për lëvrimin e pjesëve rezervë do të jetë 12 muaj nga lidhja e kontratës.

### **Dokumentacioni teknik shoqëruar:**

1. Manuale dhe katalogje për pjesët rezervë;
2. Certifikata e konformitetit CE për pjesët që aplikohet;
3. Certifikata e cilësisë;
4. Certifikata e origjinës ose dokumentat ekuivalente;
5. Deklaratë se mallrat janë të rinj, të papërdorur;
6. Packing list.

Bashkëlidhur karakteristikat teknike, skema elektrike dhe ilustrime me foto sipas rastit për të gjithë artikujt e sipër përmendur në listën e pjesëve rezervë për nevojat e HEC Fierzë.